



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN**  
**E TË DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 477/3 prot.

Tiranë më 07.04.2026

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektvendimit për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të platformës elektronike të raportimit financiar (PERF)

**MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 1232/4 prot. datë 13.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 477/2 prot. datë 03.04.2026, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të platformës elektronike të raportimit financiar (PERF)”, së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit të ridërguar, Zyra e Komisionerit konstaton se në tërësi janë reflektuar sugjerimet e dhëna nga ana jonë, me shkresën nr.477/1 prot., datë 18.02.2026.

Ndërkohë, lidhur me sugjerimin e dhënë për përcaktimin e bazës ligjore specifike (në pjesën hyrëse të projektvendimit) që legjitimon “Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” në cilësinë e Kontrolluesit për krijimin e platformës PERF, mendojmë që ky sugjerim duhet të reflektohet në përputhje me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektvendimin të hartuar konform legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**